



BURSA STUDIMI NË HUNGARI, VITI AKADEMIK 2018-2019

Në zbatim të programit të bashkëpunimit me Hungarinë në fushën e arsimit dhe shkencës, Qeveria e Republikës së Hungarisë, përmes **Fondacionit Publik Tempus (Tempus Public Foundation)**, për vitin akademik 2018-2019, shpall programin e bursave shtetërore "Stipendium Hungaricum" për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet pranë universiteteve të Hungarisë. Programet e studimit të ofruara përfshijnë studime të plota/të pjesshme universitare, pasuniversitare në fushën e kërkimit pranë institucioneve të arsimit të lartë ose të kërkimit të Hungarisë, sipas kategorive të ndara si më poshtë:

- **Studime të pjesshme në nivelin Bachelor / Master / doktoraturë (1-2 semestra).** Kandidatët e interesuar duhet të jenë të regjistruar dhe të kenë statusin e studentit në një nga institucionet e arsimit të lartë të vendit të tyre. Kandidatët mund të aplikojnë vetëm për studime të nivelit që janë duke ndjekur në vendin e tyre. Studimet me kohë të pjesshme nuk janë të vlefshme për kurse përgatitore apo specializimi. Këto studime janë të vlefshme maksimumi për një vit akademik pa mundësi shtyrjeje të mëtejshme.
- **Studime të plota në nivelin Bachelor (8 semestra) / Master (3-4 semestra).** Studimet me kohë të plotë janë programe që përfundojnë me marrjen e një diplome bachelor ose master. Programet bachelor zgjasin nga 2-4 vite akademike, ndërsa studimet Master nga 1.5 – 2 vite akademike. Preferohen aplikimet në fushat e studimit si vijon: bujqësi, inxhinieri, ekonomi, arte dhe shkenca natyrore. Studentët që aplikojnë për kurse master duhet të kenë përfunduar studimet bachelor dhe të kenë diplomën përkatëse për këtë nivel studimesh.
- **Studime Doktorale PHD, program i plotë (2+2 vite akademike).** Në përputhje me legjislacionin aktual në Hungari, kohëzgjatja e studimeve të doktoraturës është 8 semestra. Studimet doktorale përbëhen nga dy faza të ndryshme: e para është një periudhë 2-vjeçare që shërben për trajnim profesional dhe kërkim, ndërkohë që periudha e dytë shërben për realizimin e kërkimit dhe disertacionin. Në përfundim të fazës së parë studentët janë të detyruar t'i nënshtrohen një provimi që synon të masë progresin arsimor dhe kërkimor. Kandidatët që aplikojnë për këto studime duhet të kenë një diplomë të nivelit master. Kandidatët për doktoratë duhet të kontaktojnë gjithashtu me institucionet e tyre pritëse me qëllim për të diskutuar temat kërkimore që do të përfshihen gjatë përgatitjes së materialeve të aplikimit (p.sh. Plani i kërkimeve).
- **Kurse përgatitore dhe specializimi me kohë të plotë (deri në 1 vit)** Krahas programeve të studimit, pala hungareze ofron bursa për kurse përgatitore të gjuhës hungareze dhe në raste të veçanta të gjuhës angleze, si dhe specializime në degë të veçanta, me kohë të plotë deri në 1 vit për të gjithë ata kandidatë që kanë diplomë në një program të caktuar studimi të nivelit Bachelor ose Master nga një institucion pritës.

Për të gjitha nivelet e studimit, kandidatët duhet të plotësojnë kushtin e nivelit të njohurive gjuhësore të përcaktuara nga programi i studimit për të cilin do të aplikojnë. Programet e studimeve ofrohen kryesisht në gjuhët angleze dhe hungareze, por edhe në gjuhët gjermane ose frënge në disa programe të caktuara studimi. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë për programet e studimit vetëm nëse ata plotësojnë kriteret minimale të gjuhës (B2) të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë pritës. Për kandidatët që aplikojnë për programe studimi në gjuhën hungareze, por që nuk kanë njohuritë e duhura për këtë gjuhë, do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës hungareze.

Gjithashtu, çdo kandidat mund të aplikojë deri në **3 (tri) programe** të ndryshme studimi sipas preferencës në të njëjtën institucion pritës ose në institucione të ndryshme pritëse. Nënvizojmë se kandidatit i humbet e drejta të ndryshojë rendin e preferencës me përfundimin e procedurës së aplikimit dhe dorëzimit të dokumenteve përkatëse.

Lista e plotë e programeve të studimit dhe të institucioneve pritëse hungareze gjenden në faqen e internetit: <http://studyinhungary.hu/study-in-hungary/menu/find-a-study-programme/study-finder.html>

Mosha e rekomanduar për kandidatët universitarë është 18 vjeç.

Për këto bursa studimi të gjithë kandidatët duhet të aplikojnë **ONLINE** në faqen <http://studyinhungary.hu/study-in-hungary/menu/stipendium-hungaricum-scholarship-programme> të Fondacionit Publik Tempus deri në datën **16 shkurt 2018 (afati fundit)**. Përveç kësaj, kandidatët duhet të dorëzojnë nëpërmjet postës në Drejtorinë e Integrimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të gjithë dokumentet e ngarkuara në sistemin online deri në datën **23 shkurt 2018 (afati i fundit)**. Sqarojmë se me postë duhet të dërgohen vetëm kopjet e noterizuara të dokumenteve të legalizuara dhe të përkthyer në gjuhën hungareze/angleze të dokumentacionit të kërkuar. Nuk do të merret në shqyrtim asnjë aplikim, i cili është ngarkuar vetëm në sistemin online të Fondacionit TEMPUS, por nuk është dërguar me postë në adresë të Ministrisë së Arsimit.

Dokumentacioni duhet të shoqërohet me kërkesën e kandidatit drejtuar MASR (ku të jepet një adresë kontakti e-maili dhe numër telefoni), duke specifikuar fushën e studimit në të cilën dëshiron të studiojë kandidati.

Bursa mbulon shpenzimet e ushqimit, të akomodimit dhe tarifën e shkollimit dhe siguracionin shëndetësor. Ndërsa shpenzimet udhëtimit duhet të mbulohen nga vetë kandidatët.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit referojuni materialeve informativë (bashkëlidhur) dhe adresave në web-site:

<http://www.studyinhungary.hu>;

<http://tka.hu/international-programmes/4133/information-for-applicants>;

<http://studyinhungary.hu/study-in-hungary/menu/find-a-study-programme/study-finder.html>;

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT,
MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**